

KONTRATE
SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 29.09.2021, lidhet kjo kontrate shitje kuotash si me poshte vijon:

PALA SHITESE : **Donika Gjoka**, e bija Rexhepit, lindur më 13.04.1962, ne Lushnje dhe banues në Lushnje, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin Nr.033861467 dhe nr personal G25413172H.

PALA BLERESE: **Ervin Droboniku**, i biri i Muratit, lindur me 09.01.1976, ne Barikat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. 033957918 dhe nr. personal H60109048P.

Palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash si me poshte:

KUSHTE PARAPRAKE:

1. Pala shitesse ne baze te Ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, eshte ortak me 1 pjese e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise "Das Raum Productions", e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 05.01.2017, me Nipt L71305064N.
2. Kapitali i shoqerise eshte 1000 leke, dhe pala shitesse eshte zoterues i 1 pjese e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise.
3. Sipas rezultatit te kerkimit te leshuar nga Regjistri i Barreve Siguruese, per shitesin, nuk ka asnje barre te regjistruar .
4. Ortaku ka vendosur, transferimin nepermjet shitjes te 100% te pjeses qe ajo zoteron, e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise "Das Raum Productions", pales blerese Ervin Droboniku.

Neni 1- Baza Ligjore

Kjo kontrate lidhet ne baze te nenit 705 e vijues te Kodit Civil Shqiptar, Nenit 73, paragrafi1, shkronja c e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare », i ndryshuar.

Neni 2 - Objekti i kontrates

Pala shitesse, transferon ne ane te kesaj kontrate, me vullnet te lire e te plote ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Statutit te Shoqerise, 100% te pjeses qe ai zoteron, me vlere te pergjithshme 1000 leke (njemije leke), qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise "Das Raum Productions" SHPK.



Neni 3- Çmimi i shitjes dhe menyra e likuidimit

Çmimi i shitjes se 100% te pjeses qe zoteron pala shitesse ne shoqerine "Das Raum Productions" SH.P.K. dhe qe transferohen nepermjet kesaj kontrate ne favor te bleresit eshte 1000 leke(njemije leke).

Çmimi i blerjes eshte paguar nga bleresi jashte kesaj zyre noteriale.

Neni 4- Garancite

Pala Shitesse deklaron dhe garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i pjeses qe transferohet nepermjet kesaj kontrate dhe se ajo eshte e lire nga çdo barre apo pretendim tjetër ligjor.

Neni 5- Heqje dore nga te drejtat

Pala Shitesse deklaron nen pergjegjesine personale, se heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne ne cilesine e ortakut te shoqerise ne lidhje me pjeset qe transferon, pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

Neni 6- Efekte ligjore

1. Pas realizimit te ketij transferimi, me nenshkrimin e kesaj kontrate :
 - Znj.Donika Gjoka, largohet plotesisht si ortak i shoqerise.
 - Z.Ervin Droboniku behet ortak i shoqerise me 1 pjese e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise.
2. Me nenshkrimin e kesaj kontrate pala shitesse humbet çdo te drejte pronesie mbi pjesen e kuotes se kapitalit qe transferon, te drejta te cilat jane transferuar tek pala blerese.

Neni 7- Zgjidhja e mosmarreshjeve

Çdo lloj mosmarreshje qe mund te linde ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e kesaj kontrate, do te zgjidhet me mirekuptim ndermjet paleve, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e ketyre mosmarreshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

PALA SHITESE

DONIKA GJOKA

Donika Gjoka
[Signature]



PALA BLERESE

ERVIN DROBONIKU

Ervin Droboniku
[Signature]